

Fuqi e krijuar në Gjermani

Ne në Bosch projektojmë motorë për të sjellë ndryshimin me nivelin më të lartë të saktësisë në inxhinieri.

Garanci 10-vjeçare për motorin.

Nuk është thjesht një frazë - ne e garantojmë vërtetë këtë. Një garanci për motorin për 10 vitet e ardhshme.

Kushtet e garancisë për fshesat me korrent me motorin Bosch.

Përveç garancisë për pajisjen tuaj, ne ofrojmë garancinë e mëposhtme për pajisjet e reja të pajisura me një motor Bosch (e vlefshme për të gjitha fshesat me korrent me cilindër pa qese ose me qese, përveç modeleve të serisë 2 BGS05.../BGC05...) të blera nga data 1 gusht 2019 dhe në vazhdim. Kërkesat ndaj shitësit në kuadër të garancisë që lindin nga kontrata e blerjes nuk preken nga këto.

1. Ne, BSH Hišni aparati d.o.o. Nazarje, Savinjska cesta 30, 3331 Nazarje, ofrojmë një garanci për defektet në motorin Bosch që janë shkaktuar në mënyrë të dukshme nga një defekt material dhe/ose i prodhimit.
2. Kushti për dhënien e garancisë është regjistrimi i fshesës me korrent dhe aktivizimi i garancisë në <http://promovime.ks.bosch-home.com> brenda 6 muajve nga blerja nga blerësi i parë.
3. Periudha e garancisë është 10 vjet duke filluar nga data e aktivizimit të garancisë sipas Pikës 2 më sipër nga blerësi i parë. Garancia është e vlefshme në territorin e Republikës së Kosovës. Kërkesa në kuadër të garancisë duhet të paraqitet brenda kësaj periudhe duke dërguar faturën origjinale të blerjes te zyra e shërbimit të klientit të përcaktuar në direktorinë e shërbimit të klientit në manualin e udhëzimeve.
4. Pavarësisht nga Pika 1 më sipër, një detyrim i garancisë nuk do të zbatohet nëse defekti në motor i atribuohet keqpërdorimit ose mosrespektimit të udhëzimeve të përdorimit dhe të montimit. Kërkesa në kuadër të garancisë skadon nëse riparimet ose ndërhyrjet kryhen nga persona që nuk janë të autorizuar nga ne për ta bërë këtë. Kërkesat në kuadër të garancisë nuk zbatohen gjithashtu për defektet e shkaktuara gjatë transportit pas dorëzimit të pajisjes, për defektet e shkaktuara nga montimi ose mirëmbajtja e gabuar, për defektet mekanike të shkaktuara nga përdoruesi, për defektet e shkaktuara nga voltazhi shumë i ulët ose shumë i lartë dhe për defektet e shkaktuara nga forca madhore.
5. Në rast të një kërkesë në kuadër të garancisë, motor Bosch me defekt do të riparohet ose do të zëvendësohet nga një motor i ri Bosch. Pjesët ose pajisjet e ndërrimit bëhen pronë e jona.
6. Shërbimet e garancisë nuk e zgjatin periudhën e garancisë, si dhe as nuk caktojnë fillimin e një periudhe të re garancie.
7. Kjo garanci nuk sjell kërkesa të mëtejshme. Garancia aktuale nuk i kufizon të drejtat statutore, veçanërisht kërkesat ndaj shitësit në kuadër të garancisë që lindin nga kontrata e blerjes dhe Ligji nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e konsumatorit dhe kërkesat e mundshme ndaj prodhuesit që lindin nga Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e përgjithshme të produkteve.
8. Këto kushte të garancisë zbatohen për të gjitha fshesat me korrent me cilindër pa qese ose me qese të blera nga data 1 gusht 2019 dhe në vazhdim, të cilat janë të pajisura me një motor Bosch, përveç modeleve të serisë 2 BGS05.../BGC05....